

Përshëndetje!

Në përgjigje të kërkesës për informacion, lidhur me veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), Bashkia Peqin, për periudhën 01.01.2025- 17.12.2025, ju informojmë si më poshtë:

1. Në zbatim të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, si dhe ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë " gjatë periudhës së sipërcituar nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Peqin, janë mbajtur 13 akte konstatimi për shkelje të legjisllacionit në fushën e ndërtimit.
2. Si rezultat i akteve të konstatimit, në përputhje me nenet përkatëse të ligjit nr 107/2014, janë marrë 13 vendime për vendosje gjobe administrative, si dhe 13 vendime administrative për prishje objekti, për ndërtime të kryera pa leje.
3. Nga vendimet administrative të marra, 5 prej tyre janë ankimuar dhe ndodhen aktualisht në proces shqyrtimi gjyqësor, në përputhje me nenin 135 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ndërsa pjesa tjetër e vendimeve ka marrë formë të prerë administrative.

Kjo përgjigje jepet në zbatim të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", si dhe në përputhje me detyrimet ligjore të autoritetit publik për transparencë dhe informim.

Faleminderit!

Eliana Beheluli
Koordinatori për të drejtën e informimit
Bashkia Peqin